

Titulli i lëndës: TEORIA E STRUKTURAVE I

Informatat themelore për lëndën			
Njësia akademike:	Fakulteti i Ndërtimtarisë		
Titulli i lëndës:	Teoria e Strukturave I		
Niveli:	Baçelor		
Statusi i lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	II-(dyte)		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Kreditë ECTS:	9		
Koha / Vendi:	Sipas orarit te shpallur		
Mësimdhënësi:	Prof.Asoc.Fatos Pllana		
Të dhënat kontaktuese:	e-mail: fatos.pllana@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë trajton sistemet statikisht të caktuara, ku në kuadër të tyre trajtohen ndikimet MTN, vijat ndikuese të mbajtësit ram dhe ata kapriatë me metodat statike dhe kinematike, trajtohen zhvendosjet e gjeneralizuara të pikave të mbajtësit, diagramet e zhvendosjeve të mbajtësve të plotë dhe kapriatë si dhe në fund trajtohen vijat ndikuese për zhvendosje të gjeneralizuara për mbajtës të plotë dhe mbajtës kapriatë		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit të kësaj lënde është që studenti të aftësohet për llogaritjen e sistemeve statikisht të caktuara të sistemeve ram dhe kapriatë, metodat të cilat aplikohen për llogaritjen e këtyre sistemeve si dhe përvetësimin e njohurive mbi vijat ndikuese. Të kryejë obligimet e detyrave-elaborateve ku është i përmbledhur plan programi i ligjëratave të konstruksionet statikisht të caktuara. Të jetë i përgatitur dhe i aftë për ndjekjen e studimeve vijuese të nivelit Master.		
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Të kuptojnë sistemet statike të konstruksioneve ndërtimore, të kuptojnë ndërtimin e diagrameve statike MTN, të kuptojnë ndërtimin e vijave ndikuese te sistemet ram dhe kapriatë me metodat statike dhe kinematike, të kuptojnë zhvendosjet e gjeneralizuara, diagramet e zhvendosjeve të mbajtësve ram dhe kapriatë, vijat ndikues për zhvendosje të gjeneralizuara. Ne bazë të përvetësimit të materialit të përshkruar më lartë të jetë në gjendje të bëjë një analizë kompletë për konstruksionet ram dhe kapriatë.		
Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)			
Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	3	15	45
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike	0	0	0
Përgatitje për test intermediar	4	3	12
Konsultime me mësimdhënësin	4	3	12
Puna në terren	0	0	0
Testi, punimi seminarik	5	4	20

Detyrë shtëpie	3	15	45
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja për provimin final	2	5	10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	3	6
Projektet, prezantimet, etj.	0	0	0
Shto ndonjë aktivitet tjetër që nuk është në tabelë...			
Total			225

Metodat e mësimdhënies: Ligjërohet në kuadër të lëndës e cila përfshinë sistemet statikisht të caktuara. Ç'do orë e ligjëratave shoqërohet me nga një shembull për sqarim të ligjëratës së mbajtur. Studenti përpilon detyrat e parapara në ushtrime në formë të elaborateve të cilat në fund të semestrit është i obliguar ti dorëzojë.

Metodat e vlerësimit: Gjatë semestrit mbahen këto vlerësime:

- prezenca e obligueshme,
- Provimi me shkrim 40%,
- Provimi me gojë 60%

Literatura primare: Ligjëratat e mbajtura në formë manuale-me shumës

- Literatura shtesë:**
1. **Jagxhiu F.:** Rezistenca e materialeve (pjesa e parë), Universiteti i Prishtinës, FNA, Prishtinë, 1995
 2. **Skenderi S.:** Statika e ndërtimit I, Revista-Dispensa, Tiranë, 1974
 3. **Skenderi S.:** Statika e ndërtimit II, Revista-Dispensa, Tiranë, 1975
 4. **Skenderi S.:** Statika e ndërtimit III, Revista-Dispensa, Tiranë, 1975
 5. **Pllana F.:** Ligjerata të autorizuaranga lënda "Statika e Konstruksioneve" I, FNA, Prishtinë, 1996
 6. **Softa F.:** Teoria e Strukturave, Tiranë, 1990

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Hyrje Ndikimet MTN dhe kuptimi i tyre Shembull
Java 2:	Metodat e analizës së konstruksioneve
Java 3:	Pacaktueshmerisë statike Ngarkesat
Java 4:	Teoria e deformimeve të vogla Analiza kinematike e konstruksioneve
Java 5:	Harku me tri sharniera Mbajtësi llanger Kuptimi i vijave ndikuese Metoda analitike e ndërtimit të vijave ndikuese
Java 6:	Vijat ndikuese te trajet sekondare Vijat ndikuese te trajet e Gerberit Vijat ndikuese te harku me tri sharniera Vijat ndikuese te mbajtësi llanger
Java 7:	Caktimi i pozicionit me të disfavorshëm nga ndikimi i ngarkesës lëvizëse

	<i>Vijat ndikuese te mbajtësit kapriatë</i>
Java 8:	<i>Bazat e mekanizmit kinematike Kuptimi i vijave ndikuese me metodën kinematike</i>
Java 9:	<i>Vijat ndikuese te harku me tri sharniera Vijat ndikuese te mbajtësit kapriatë me metodën kinematike</i>
Java 10:	<i>Principi i punëve virtuale Puna virtuale e forcave të brendshme Principi i zhvendosjeve virtuale</i>
Java 11:	<i>Metoda e zhvendosjes njësi Principet numerike për të llogaritjen e zhvendosjeve të gjeneralizuara</i>
Java 12:	<i>Teoremat e reciprocitetit</i>
Java 13:	<i>Diagramet e zhvendosjeve të mbajtësit e plotë Diagramet e zhvendosjeve te mbajtësit kapriatë</i>
Java 14:	<i>Vijat ndikuese për zhvendosje të gjeneralizuara te mbajtësit e plotë Vijat ndikuese për zhvendosje të gjeneralizuara të mbajtësit kapriatël</i>
Java 15:	<i>Rekapitullimi i të gjitha njësive mësimore</i>

Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes

Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.

Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.

Shënim | Nëse 3 detyra të klasës të një studenti vlerësohen nën 50%, atëherë ai/ajo do ta humb të drejtën që t'i nënshtrohet provimit final. Vlerësimi bëhet nga 0-100 %.